

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
|---------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Futi produkte "Botox" kontrabandë, merret i pandehur biznesmeni Dritan Gremi i "Gremi Wellnes". Reagi mi i sipërmarrësit: E vërteta e akuzave ndaj meje                                                                                                                                                                                                               |
| ADRESA  | <a href="https://kohajone.com/lajme/futi-produkte-botox-kontrabande-merret-i-pandehur-biznesmeni-dritan-gremi-i-gremi-wellnes-reagimi-i-sipermarresit-e-verteta-e-akuzave-ndaj-meje/">https://kohajone.com/lajme/futi-produkte-botox-kontrabande-merret-i-pandehur-biznesmeni-dritan-gremi-i-gremi-wellnes-reagimi-i-sipermarresit-e-verteta-e-akuzave-ndaj-meje/</a> |
| BURIMI  | kohajone.com                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 18 shtator 2026, 10:48:35 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 10:45:49 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | ca29d8817832781fbb3fd23b37f5af0ad46b4c2a2422ffaea91186236e6a481a |
| TEKSTI     | 890cdc3b5d7331c833e616f5b019b6b80f1fa35d6a7baf5338c8292ba986a10  |
| PAMJA      | 1dae9dceacb56b77a192fe064d410bdf1be36fbf20897200aa6fe886cd0bdb05 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                                                                                    |
|---------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 08e71f4b532e8ffe4ff92cc86302fda92b4afe07c7ab1d22dd26bed870911346                                                                                                   |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                                                                                                  |
| RRËNJA MERKLE | —                                                                                                                                                                  |
| ANKORIMI      | nuk është ankoruar ende<br><i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/08e71f4b532e8ffe4ff92cc86302fda92b4afe07c7ab1d22dd26bed870911346>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



# Futi produkte “Botox” kontrabandë, merret i pandehur biznesmeni Dritan Gremi i “Gremi Wellnes”. Reagimi i sipërmarrësit: E vërteta e akuzave ndaj meje

LAJME E PREMTE, 18 SHTATOR 2026 12:45



Gremi Wellnes

Një dosje hetimore që bën fjalë për “kontrabandim të medikamenteve mjekësore” dhe “Fshehjen e të ardhurave financiare” është regjistruar në gjykatën e Tiranës, me të pandehur Dritan Gremi dhe shoqërinë Juridike, “Gremi Wellnes”. Çështja penale me emrin e biznesmenit të disa klinikave estetike dhe 11 bizneseve të hapura në Tiranë dhe Elbasan, është publikuar si i pandehur në seancat gjyqësore që gjykata e Tiranës, ka planifikuar të gjykojë në 22 shtator 2026.

Kujtojmë se në muajin Tetor 2025, Dritan Gremi, u shfaq dhe si kandidat i pavarur për të garuar në zgjedhjet për kryetar bashkie në Tiranë, zgjedhje këto që nuk u zhvilluan kurë.

Mësohet se dosja me 2 të pandehur është ende në fazën e shqyrtimit gjyqësor në seancën paraprake dhe gjyqtare e çështjes është caktuar përmes shortit elektronik, Amarilda Sulaj.

Sipas dosjes hetimore, të pandehurit Dritan Gremi dhe shoqëria e tij “Gremi Wellnes” dyshohet se kanë kryer kontrabandë të medikamente mjekësorë, kryesisht “Butox” me princip aktiv “Botulinum toxin”.

Ky medikament mjekësor aktualisht nuk është i paisur me autorizim për tregtim në Shqipëri.

Ndërkohë edhe paisjet mjekësore që vendosen në treg në Republikën e Shqipërisë, duhet të regjistrohen në Regjistrin Kombëtar të Paisjeve Mjekësore, procedurë kjo që mbahet nga Agjensia Kombëtare e Barnave dhe Paisjeve Mjekësore.

Në emër të Dritan Gremi, vijnë të jenë disa kompani të tjera si “Gremi Longevity Center”, “My Albania News”, “Gremi Sweet Bread”, “La Belle Noiseuse”, “Hotel Serenity”, “Gremi Clinic”, “Dritan Gremi”, “Viaggiare e Sorridere” e të tjera.

## LAJMET KRYESORE



Presidenti Begaj dekreton ligjin për rritjen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve



BE kërkon kufizime më të repta për rrjetet sociale



Rama në Kuvend: Gjykatësit s'mund të kenë pagat më të larta në vend. KLGJ e KLP kanë dështuar



Berisha hedh dyshimin e madh: A e pagoi Hashim Thaçi projektin për ndryshimin e kufijve?



Reagon avokati i Hashim Thaçit

## TË PËRZGJEDHURA



Hamilton mohon kategorikisht: “S’kam kërkuar ndryshime stafi te Ferrari”



Klopp thërret 44 lojtarë për Gjermaninë: “Krenaria kombëtare të mos u besohet njerëzve të gabuar...”



Berisha hedh dyshimin e madh: A e pagoi Hashim Thaçi projektin për ndryshimin e kufijve?



Edmond Spaho te Nikoll Lesi: PD ka mbaruar, nuk vjen ne pushtet!



Luka Modric konfirmon pjesëmarrjen me Kroacinë në Ligën e Kombeve

## MË TË LEXUARAT

## Reagimi i biznesmenit

### Dy fjalë për lajmin e qarkulluar sot në media.

E gjithë kjo histori nisi sepse nuk pranova t'i nënshtrohesha presionit të një OPGJ-je të Prokurorisë së Tiranës dhe një prokurori që e mbështeste, në kuadër të një hetimi për tregtimin e botoksit në Tiranë.

Pasi denoncova publikisht mënyrën se si, sipas meje, ishte vepruar ndaj meje dhe biznesit tim, ajo që pasoi më krijoi bindjen se po përballesh edhe me pasojat e faktit që kisha zgjedhur të mos heshtja.

### Biznesi im nuk tregtonte botoks. As atëherë, as sot.

Gjatë kontrollit u thirrën rreth 10 efektivë të "Shqiponjave", pasi OPGJ-të pretenduan se ishin ndier nën presion nga dy vajza të stafit tim.

U kërkua gjithashtu login-i dhe aksesit në databazën e klinikës. Sipas dokumentacionit që disponoj, kjo nuk ishte objekt i kontrollit dhe nuk kishte autorizim gjyqësor. Ligjshmërinë e këtij veprimi e kam kundërshtuar që atëherë.

U morën dhe u kontrolluan rreth 1,600 dosje pacientësh.

Dhe pas gjithë këtij kontrolli, sa botoks u gjet në biznesin tim?

### ZERO. As edhe një gram.

Nga rreth 1,600 dosje u evidentuan 11 persona, kryesisht miq të mi, të trajtuar falas.

Kam deklaruar që në fillim se nuk jam marrë me blerjen, sigurimin apo tregtimin e botoksit, nuk kam ditur ku blihej, nga kush sigurohej apo sa kushtonte dhe **nuk kam pasur interes ekonomik nga këto trajtime**.

Megjithatë, sot përballëm edhe me akuzën sipas **nenit 178 të Kodit Penal** – "Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë".

Ligji parashikon tregtimin, tjetërsimin ose transportimin e mallrave **për të cilat dihet se janë kontrabandë**.

Prandaj pyetjet e mia juridike janë shumë konkrete:

**Cili është malli kontrabandë që pretendohet se kam tregtuar?**

**Ku është gjetur?**

**Cila është prova që unë e kam tregtuar, tjetërsuar apo transportuar?**

**Dhe cila është prova që unë e dija se ky mall ishte kontrabandë?**

Në biznesin tim, sipas akteve që disponoj, **nuk u gjet dhe nuk u sekuestrua asnjë gram botoks**.

Por ka edhe një pyetje tjetër që meriton përgjigje.

Nëse gjatë të njëjtit hetim, siç rezultojnë nga informacioni që disponoj, në subjekte të tjera janë gjetur dhe sekuestruar sasi botoksi, por persona të tjerë nuk janë dërguar për gjykim, ndërsa unë përballëm me këtë akuzë edhe pse në biznesin tim nuk u gjet botoks, atëherë kam të drejtë të pyes:

**Cili është shpjegimi juridik për këtë diferencë?**

Nëse ekziston një shpjegim ligjor, jam i pari që dua ta dëgjoj.

**Sepse ligji duhet të zbatohet njësoj për të gjithë.**

Këtë histori nuk po e denoncoj sot sepse doli në media. **E kam denoncuar publikisht që në fillim** dhe vazhdoj ta mbroj qëndrimin tim përmes rrugëve ligjore.

**Për gazetarin që publikoi lajmin: mendoj se ke gabuar.**

Kjo çështje është e hapur që prej dhjetorit 2025. Nuk ka lindur sot, dje apo javën e kaluar. Megjithatë, ti zgjodhe ta publikosh vetëm pak ditë përpara seancës së parë gjyqësore, me një titull që e paraqiste "futjen e botoksit kontrabandë" sikur të ishte një fakt tashmë i provuar.

**Një akuzë nuk është fajësi. Fajësinë e vendos gjykata.**

Për mua, koha e publikimit ngre një pyetje të ligjshme:

**Pse pikërisht tani?**

Nuk e di nga ka ardhur informacioni dhe nuk dua të paragjykoj motivin. Por një gazetar kronike e di shumë mirë peshën që ka një akuzë penale dhe dëmin që mund të shkaktojë kur paraqitet publikisht si fakt i provuar përpara se të ketë folur gjykata.

Dhe po ta them edhe për një arsye tjetër: kur ti vetë ke pretenduar publikisht se ndaj teje është bërë padrejtësi, edhe pa të njohur personalisht, **ke pasur solidaritetin tim**.

Prandaj besoj se figura e gazetarit duhet mbrojtur, por mbrohet mbi të gjitha me **profesionalizëm, verifikim dhe respekt për prezumimin e pafajësisë**.

Pas sqarimit tim, **të gjitha mediat që e kishin publikuar lajmin e hoqën atë**. I falënderoj publikisht drejtuesit e tyre për profesionalizmin dhe përgjegjshmërinë.

Dhe dy fjalë për drejtësinë.

**Jam plotësisht dakord që prokurorët, gjyqtarët dhe OPGJ-të të kenë paga të larta dhe dinjitoze.**

Përgjegjësia që mbajnë është e jashtëzakonshme dhe profesionistët e ndershëm duhet të paguhën mirë dhe të kenë mbështetjen e shoqërisë.

Por paga, autoriteti dhe pushteti që jep ligji duhet të shoqërohen edhe me **përgjegjësi të lartë për mënyrën se si ushtrohet detyra**.

Nëse institucionet kompetente provojnë se dikush ka abuzuar me detyrën, ai nuk duhet të dëmtojë me sjelljen e tij figurën

e qindra prokuroreve, gjyqtareve dhe punonjesve të drejtësisë që e bëjnë punën me ndersnmeri.

**Kam respekt maksimal për njerëzit e drejtësisë që zbatojnë ligjin me integritet.** Por respekti për drejtësinë nuk do të thotë të heshtësh kur mendon se ndaj teje është vepruar padrejtësisht.

**Unë nuk heshta atëherë dhe nuk kam ndërmend të hesht sot.**

Dhe për këdo që dëshiron të kuptojë se si nisi kjo histori dhe çfarë kam denoncuar që atëherë, kam vetëm një kërkesë:

© BalkanWeb

ETIKETA DRITAN GREMI GREMI WELLNES

## MË SHUMË NGA LAJME



**Rama fton magistratët: Të ulemi në një tryezë pune, kërkojmë një zgj...**



**Betohet te Presidenti Begaj ministri i ri i Brendshëm, Ervin Demo**



**Rekomandimet e KiE për paraburgimin, ministri Gogu: Po rishikojmë Kod...**

**Rama mbledh ministrat dhe drejtuesit politikë të "Vila e kuqe&#...**

**Kuvendi miraton emërimin e Ervin Demos si ministër të Brendshëm, prit...**

**Kuvendi miraton me 84 vota rritjen me 2% të pagave të magistratëve. ...**

## LAJMET E FUNDIT



**Rama fton magistratët: Të ulemi në një tryezë pune, kërkojmë një zgjidhje të qëndrueshme afatgjatë për pagat**

[48 MINUTA MË PARË](#)



**Betohet te Presidenti Begaj ministri i ri i Brendshëm, Ervin Demo**

[1 ORË E 0 MINUTA MË PARË](#)



**Trump paralajmëron bazë të re amerikane në Poloni: Po bëhet përparim i madh**

[1 ORË E 24 MINUTA MË PARË](#)



**Rekomandimet e KiE për paraburgimin, ministri Gogu: Po rishikojmë Kodin e Procedurës Penale**

[1 ORË E 31 MINUTA MË PARË](#)



**Sherri i dhunshëm në Sarandë. Dy vëllezërit plagosen brenda berberhanes, përleshja vijon edhe jashtë**

[1 ORË E 48 MINUTA MË PARË](#)



**Ylli Manjani: Ku e lamë?! Te rregullorja**

[1 ORË E 52 MINUTA MË PARË](#)

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >

Gazeta "KOHA JONE" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991  
Botues: Nikoll LESI. Adresa e redaksisë: Rruga "Samë Frasheri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

TË FUNDIT

LAJME

SPORTI

EKONOMI

EDITORIAL

WEBTV

AKTUALITET

RAJONI

KOSOVA

BOTA

TEKNOLOGJI

SHOWBIZ

SHËNDETI

SOCIALE

TURIZËM

KURIOZITETE

KULTURA

HISTORIKU

KONTAKT

BOTUES & DREJTOR: Nikoll LESI

KRYEREDAKTOR: Daniel MUÇAKU

ZV/KRYEREDAKTOR: Redjon SHTYLLA

BORDI: Elsa KAMBERI, KRYETARE

NIPT: J71425013C



NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA

SD

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.